



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 324 / Prot.  
3

Bllatë, më 11 / 05 / 2026

Lënda: Kërkesë për njoftim publik



**DREJTORISË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**

**DREJTORISË SË STATISTIKËS, PAGESAVE, ANALIZËS SË TË  
ARDHUARVE DHE ADMINISTRIMIT TË BORXHIT**  
Sektorit të Monitorimit të Borxhit dhe Bashkëpunimit me Tatimet

**DEPARTAMENTIT EKONOMIK DHE BURIMEVE MBËSHTETËSE**  
**DREJTORIA E ASETVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**TIRANË**


Në zbatim të marrjes së masave për rikuperimin e borxhit doganor, mbështetur në ligjin Nr.102/2014, datë 31.07.2014 « Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë », i ndryshuar , Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 të DPD-së « Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës », kreu IV, pika 3/b, si dhe Ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 « Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë » neni 162, pika 2 , kërkojmë kryerjen e njoftimit publik të vendimit nr.26, datë 17.03.2026 të Degës Doganore Bllatë (Peshkopi), të marrë ndaj subjektit « Mega Plast -2L, me NIPT L56615701K, duke e publikuar në rubrikën « Njoftime » të faqes “ëeb” të Institucionit.

Bashkëlidhur keni kopje të vendimit nr.26 , datë 17.03.2026, të Degës Doganore Bllatë dhe shkresën “Njoftim Vendimi”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**Bajram KALIA**



Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 324/2 Prot.

Bllatë, më 17/03/2026

Lënda: Njoftim vendimi borxhi doganor

Subjektit: "Mega Plast-2L" sh.p.k. me NIPT: L56615701K

Adresa: *Bashkia Dibër, Njësia Administrative Peshkopi, rruga "Gjokë Doçi", Zona Kadastrale nr.2932,*

**PESHKOPI**

Në zbatim të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

**Ju njoftojmë se:**

Në vijim të verifikimeve doganore të kryera ndaj subjektit tuaj, lidhur me zbatimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv, është konstatuar se keni kryer shkelje administrative në zbatimin e dispozitave që rregullojnë zbatimin e Regjit të Përpunimit Aktiv.

**Për këto arsye:**

**Me vendimin e Degës Doganore Bllatë, me Nr. 26, datë 17.03.2026 ( një kopje të të cilit e keni bashkëlidhur), subjekti "Mega Plast 2L" sh.p.k., është shpallur debitor për:**

- shumën **50,000** lekë, saksion.


Sa më sipër, luteni që brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të kryeni pagesën e shumës së mësipërme sipas faturës për arkëtim që e keni bashkëlidhur këtij njoftimi. Në të kundërt, Administrata Doganore do të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të saksionit të papaguar.

Bashkëngjitur keni një kopje të Vendimit nr. 26, datë 17.03.2026 të Degës Doganore Bllatë.

**KRYETAR**

**Bajram KALIA**

Adresa : Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 324/1 Prot.

Bllatë, më 17/03 / 2026

V E N D I M   N r . 26

Në Degën Doganore Bllatë, më datë 17.03.2026, unë, Kryetari i Degës Doganore Bllatë, pasi shqyrtova procesverbalin nr.1339 prot., datë 27.10.2025, të mbajtur nga Arben Ndreu me detyrë përgj. Zyrës Mbikëqyrjes Doganore, Greta Skuka me detyrë doganiere në Zyrën e Mbikëqyrjes Doganore ndaj subjektit "Mega Plast -2L" me NIPT L56615701K,

**K O N S T A T O V A :**

Subjekti "Mega Plast -2L" është pajisur me autorizim nr.AL2309/1, datë 02.08.2023 nga autoriteti doganor për zhvillim të aktivitetit ekonomik nën Regjimin e Përpunimit Aktiv, regjim i cili mbikqyret nga Dega Doganore Bllatë.

Zyra e Mbikqyrjes Doganore në kontrollin e ushtruar lidhur me respektimin e kushteve të vëna në autorizim, konkretisht afateve brenda të cilave mallrat joshqiptare duhet të përpunohen dhe rieksporthen nga territori i Republikës së Shqipërisë, ka konstatuar se subjekti i ka rieksportuar gjithë sasinë e mallrave të importuar, duke marrë parasysh që afati i përpunimit është 1 vit, eksporti i fundit është më datë 01.10.2024.

Në bazë të udhëzimit nr.04, dat 28.03.2019 "Për zbatimin proktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv", Seksioni II, pika 13 "Afati për mbyllje", dhe seksioni XIV, pika 2 "Detyrimet e operatorit ekonomik", pasi të përfundojë afati i vlefshmërisë së autorizimit, përfshirë këtu edhe kohën e përpunimit të përcaktuar në pikën 13 të autorizimit, operatori ekonomik është i detyruar të dorëzojë pranë degës doganorë mbikqyrëse dokumentin e mbylljes së autorizimit sipas aneksit 8. Koha e dorëzimit nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë. Ky afat mund të shkojë deri në 60 ditë kur operatori ekonomik paraqet arsye për të justifikuar këtë zgjatje afati.

---

Deri më datë 27.10.2025, rezulton se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar dokumentin e mbylljes së regjimit, Aneksin 8, sipas udhëzimit të sipërcituar dhe pas kalimit të afatit prej 60 ditësh. Mosparaqitja në afat i dokumentit të mbylljes së autorizimit, përbën shkelje administrative, shkelje kjo e parashikuar nga dispozitat e Kodit Doganor.

Për këto konstatime është mbajtur procesverbali nr.1339 prot., datë 27.10.2025 i cili i është dërguar subjektit me postë, por posta e ka kthyer mbrapsht me shënimin "Larguar", megjithëse e kemi dërguar në adresën e deklaruar të subjektit dhe administrtorit të tij.. Ndodhur në këto kushte me shkresën nr.1339/3 prot., datë 12.12.2025 i jemi drejtuar bashkisë Dibër për kryerje të njoftimit publik duke e afishuar në këndin e bashkisë dhe të njësisë administrative për

njoftime publike. Njësia administrative Kastriot me shkresën nr.133 prot, datë 25.02.2026, ka konfirmuar se ka kryer afishimin e njoftimit publik në këndin e njoftimeve më datë 20.02.2026. Sipas nenit 162 pika 3 të ligjit “Për procedurat administrative në Republikën e Shqipërisë, me kalimin e 10 ditëve nga data e publikimit njoftimi konsiderohet i kryer. Subjekti nuk ka paraqitur kundërshtime me shkrim brenda 10 ditëve nga marrja dijeni.

Në përfundim, pasi u shqyrtua i gjithë materiali i plotë i dosjes, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit Mega Plast -2L me NIPT L56615701K, është kryer kundërvajtje administrative, e parashikuar kjo në dispozitat e Kodit Doganor. Për sa më sipër, mbështetur në nenet 250/1/a, 252 dhe 257 pika 1/b të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,


#### V E N D O S A :

1. Subjektit “Mega Plast -2L” me NIPT L56615701K, për mosrespektimin e afatit kohor, brenda të duhet të kishte dorëzuar dokumentin e mbylljes së regjimit, të ndëshkohet me gjobë në masën **50,000 (pesëdhjetë mijë)** lekë, bazuar në nenin 257 pika 1/b të Kodit Doganor.
2. Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejë menjëherë kontabilizimin e penaliteteve të mësipërme dhe në bashkëpunim me Sektorin Operacional të zbatojë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e penaliteteve
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve, nga marrja dijeni, pranë Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Tiranë, sipas kriterëve të nenit 282 pika 2 të ligjit 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Për të paraqitur ankesn paraprakisht duhet të garantojë shumën e sanksionit për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Bajram KALIA**



*Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër*